

CIG

Council
for Inclusive
Governance

Përfshirja e Serbëve të Kosovës në Proceset Politike

Raport Aktivitetesh

Prishtinë, Beograd, korrik, 2011

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse

Nju Jork, 2011

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse ka organizuar në korrik të vitit 2011 një sërë aktivitete për përfaqësues serbë të Kosovës dhe zyrtarë të institucioneve të Serbisë. Aktivitetet përfshinë një tryezë të rumbullakët të organizuar në Prishtinë për zyrtarë serbë të Kosovës nga niveli lokal dhe ai qendror dhe për aktivistë të shoqërisë civile, një tryezë në Beograd për një numër të politikanëve serbë të Kosovës dhe zyrtarëve e deputetëve të qeverisë së Serbisë, si dhe një takim mes përfaqësuesve politikë të serbëve të Kosovës dhe kryetarit të kuvendit të Serbisë. CIG ka mbajtur takime individuale me zyrtarë të qeverisë së Kosovës dhe te partive politike, duke përfshirë kryetarin e kuvendit si dhe me zyrtarë të qeverisë së Serbisë dhe të partive politike atje. Pjesëmarrës në aktivitete kanë qenë anëtarë serbë të kuvendit të Kosovës, kryetarë serbë të komunave me shumicë serbe në Kosovë, zyrtarë nga Ministria për Kosovë e Serbisë, anëtarë të parlamentit të Serbisë, përfaqësues të Partisë Demokratike të Serbisë, Partisë G17 Plus, Partisë Socialiste të Serbisë, Partisë Demokratike Liberale si dhe anëtarë të shoqëris civile në Serbi e Kosovë.

Disa prej çështjeve të cilat janë diskutuar në këto aktivitete kanë qenë roli i serbëve të Kosovës në dialogun Beograd-Prishtinë, vendosja e bashkëpunimit ndërmjet Beogradit dhe përfaqësuesve serbë në institucionet e Kosovës dhe çështja e “paralelizmit” institucional ne komunat me shumicë serbe, si dhe vendosja e komunikimit dhe bashkëpunimit zyrtar midis Beogradit dhe serbëve të Kosovës të pranishëm në institucionet e Kosovës.

Këto aktivitete kanë qenë pjesë e iniciativës për të ardhmen e komunitetit serb në Kosovës, të financuar nga Departamenti Federal Zvicrran për Punë të Jashtme.

Me qëllim të nxitjes së një diskutimi të hapur, CIG nuk i atribuon idetë e paraqitura pjesëmarrësve specifik dhe kërkon mirëkuptim nga ata idetë e të cilëve nuk janë përfshirë në tërësi në këtë raport të shkurtër. Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në këto aktivitete në cilësinë personal dhe pozicionet e tyre jo domosdoshmërisht paraqesin pozicionet zyrtare të organizatave të cilat ata i përfaqësojnë.

Përfshirja e udhëheqësve politikë të serbëve të Kosovës ne dialogun Beograd-Prishtine

Në tryezën e rumbullakët në Prishtinë, të mbajtur me përfaqësuesit politikë dhe ata të shoqërisë civile të serbëve të Kosovës, pjesëmarrësit kanë rekomanduar përfshirjen e udhëheqësve serbë të Kosovës në procesin e dialogut, qoftë drejtpërdrejt apo duke caktuar një përfaqësues serb në ekipin negociator të Prishtinës. Konsulta të ngjajshme janë propozuar edhe mes serbëve të Kosovës dhe përfaqësuesve të ekipit negociator të Beogradit. Analiza dhe reagimi i serbëve të Kosovës do të mund të kontribuonte në arritjen dhe zbatimin e marrëveshjeve. Politikanët serbë të cilët nuk janë në institucionet e Kosovës dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile gjithashtu do të duhej të përfshiheshin në këtë proces. Megjithate, pjesëmarrësit janë pajtuar se, para së gjithash, dialogu është i fokusuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve më madhore ndërmjet Beogradit e Prishtinës, dhe jo aq në pozitën e komunitetit serb në Kosovë. Duke qenë i tille, ata nuk kanë pritur pjesëmarrje të fuqishme të serbëve të Kosovës në këtë proces, por as nuk kanë parashikuar përjashtimin e tyre nga procesi. “Mbi të gjitha, dialogu është për çështje të

sovrانيتit”, ka vlerësuar një pjesëmarrës. Ai në mënyrë direkte ndikon në sovranitetin dhe integritetin e Serbisë. Së këndejmi, çfarëdo progresi do të jetë i ngadalshëm dhe do të shoqërohet nga shumë vështirësi.

Pjesëmarrësit kanë përkrahur vazhdimin e dialogut, duke vlerësuar se Beogradi dhe Prishtina duhet të zgjidhin një numër të mosmarrëveshjeve madhore në mënyrë që ti përmbushin aspiratat e tyre për integrimin evropian. “Mosmarrëveshjet rreth statusit janë pengesat kryesore si për Prishtinën ashtu edhe për beogradin”, ka thënë njëri nga folësit. Shumica e pjesëmarrësve nuk kanë qenë të kënaqur me tri marrëveshjet – dokumentet e udhëtimit, diplomat e shkollave dhe tabelat e veturave – të arritura në qershor, por i kanë përshëndetur ato si zgjidhje të përkohshme të cilat në rast të implementimit do të qetësonin tejmas tensionet mes serbëve dhe shqiptarëve si dhe do të përgatitej terreni për shqyrtimin e çështjeve më delikate, sic është ajo e vulave doganore. Këto marrëveshje nuk zgjidhin problemet ashtu si shumë prej serbëve në Kosovë kishin pritur. “Tabelat e veturave do të tregojnë se kush është serb e kush shqiptar: veturat me tabelat ‘KS’ tregojnë se je serb; veturat me tabela të përkohshme serbe në Serbi tregojnë se je shqiptar.” Njohja e letërnjoftimeve të Kosovës do të zgjidhte vetëm problemin e lëvizjes së njerëzve por jo edhe të mallrave, dhe po të njëjtat nuk do të njiheshin si dokumente valide, për shembull për të hapur një biznes në Serbi. Nuk ishte e qartë po ashtu nëse diplomat e Universitetit të Mitrovicës të administruar nga serbët do të njiheshin. Një nga pjesëmarrësit ka treguar se zyrtarë të Kosovës të njohur nga afër me marrëveshjet i kanë thënë se marrëveshja për diplomat nuk parasheh njohjen e këtyre diplomave. Pjesëmarrësit kanë qenë të frikësuar se, masat e reciprocitetit ndaj Serbisë, të cilat ende nuk kishin filluar të aplikoheshin në kohën e mbajtjes së takimit, më së shumti do t’i dëmtonin serbët e Kosovës.

Mes tjerash, serbët e Kosovës nuk do të jenë më në gjendje të shfrytëzojnë tabelat e veturave të lëshuara nga Beogradi apo të importojnë mallra serbe. Ata kanë propozuar që zyrtarët qeveritar në Beograd e Prishtinë, e sidomos ministrat e brendshme respektive, duhet të organizojnë fushata informuese në mënyrë që t’u shpjegohen qytetarëve detajet e marrëveshjeve si dhe procedurat të cilat ata duhet ti përcjellin.

Shumë nga pjesëmarrësit kanë diskutuar nevojën për përmirësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit mes partive parlamentare të serbëve të Kosovës gjatë procesit të dialogut. Poashtu është konkluduar që udhëheqësit politikë duhet të mbajnë takime mujore me qëllim të koordinimit të veprimeve dhe për adresimin e çështjeve urgjente. Gjatë diskutimeve, është arritur një koncensus i përgjithshëm se përfaqësuesit e partisë parlamentare më të madhe serbe duhet të marrin përsipër organizimin e këtyre mbledhjeve. Njëri nga folësit ka kritikuar serbët në institucione për mungesë të aktivitetit në lidhje me dialogun. “Asnjëri nga tre ministrat serbë nuk ka diskutuar asnjëherë me anëtarët e ekipit negociator në mënyrë që ti japin idetë dhe këshillat e tyre rreth mënyrave për përmirësimin e problemeve të votuesve të tyre”.

Edhe pse i kanë përshëndetur që të trija marrëveshjet, pjesëmarrësit kanë shprehur dyshimet e tyre rreth implementimit, marrë parasysh përvojën e kaluar të bashkëpunimit mes Beogradit e Prishtinës dhe kundërshtimet e brendshme në Serbi dhe Kosovë kur bëhet fjalë për dialogun. Zbatimi i marrëveshjeve duhet të fillojë në muajin nëntor, por nuk parashihet një afat përmbyllës duke bërë që shumë skeptikë të besojnë se zbatimi do të mund të zvarritej me vite të tëra. Pjesëmarrësit poashtu janë ankuar për mungesë të transparencës sa i përket negociatave. “Ne

mund të diskutojmë vetëm për ato që i kemi lexuar në gazeta; nuk ekziston një dokument publik i lëshuar nga palët e përfshira në dialog”. Një numër i pjesëmarrësve ka marrë pjesë në një diskutim me kryesuesen e ekipit negociator, Edita Tahiri, por “ajo nuk na ka ofruar ndonjë informatë që nuk e kemi lexuar më parë në gazeta”.

Ceshtja e krijimit të një forumi i cili do të përfshinte përfaqësues nga i tërë spektri politik serb si dhe përfaqësues të shoqërisë civile është shtruar përsëri në diskutim. Edhe pse, në parim, pjesëmarrësit e kanë mbështetur këtë ide, pak prej tyre presin që serbët e Kosovës do t'i tejkalojnë përçarjet ndërmjet vete në mënyrë që të krijojnë një trup të tillë. Disa edhe kanë vënë në pikëpyetje arsyen e krijimit të një forumi të tillë. Ata kanë thënë se interes e serbëve duhet të përfaqësohen dhe të mbrohen nga përfaqësuesit e zgjedhur të cilët “paguhen për këtë”. Disa nga diskutuesit kanë konkluduar se krijimi i një forumi gjithëpërfshirës serb është i vështirë jo vetëm për shkak se serbët në jug janë të përçarë, por poashtu për shkak se serbët në veri vështirë se do t'i bashkangjiteshin një trupi të tillë. Njëri nga folësit ka theksuar nevojën për bashkëpunim më të afërt mes komunave me shumicë serbe.

Në dy takime të ndara, pjesëmarrësit kanë punuar në identifikimin e çështjeve të cilat ata besojnë se meritojnë trajtim parësor përbrenda dialogut zyrtar Beograd-Prishtinë. Këto çështje kanë të bëjnë kryesisht me fatin e personave të zhdukur, dokumentet personale, çështjet pronësore, telekomunikimi e në vecanti telefonia mobile, si dhe energjia elektrike. Disa nga pjesëmarrësit kanë thënë se një takim eventual mes udhëheqësve të serbëve të Kosovës dhe ministrit të punëve të brendshme të Kosovës do të ndihmonte shumë në qartësimin e funksionimit të policisë së Kosovës dhe në shkëmbimin e mendimeve rreth funksionimit të kësaj policie në hapësirat me shumicë serbe.

Porosia e pjesëmarrësve ka qenë se përfaqësuesit serb në institucione do të duhej të gjenin modele për të ndikuar më shumë në politikat qeveritare si dhe të kërkonin mënyra për të përfshirë këshillat, sugjerimet, dhe propozimet e serbëve të Kosovës në diskutimet rreth dialogut. Ata poashtu kanë bërë thirrje që dialogu të jetë më transparent dhe që ekipi negociator i Kosovës t'i thërras në konsultime kur bëhet fjalë për çështje që në mënyrë të drejtpërdrejt prekin komunitetin serb.

Zgjidhja e ‘dualizmit’ institucional

CIG ka organizuar një tryezë të rumbullakët në Beograd për përfaqësuesit serbë të Kosovës, duke përfshirë anëtarë të parlamentit të Kosovës dhe kryetarët e komunave me shumicë serbe, si dhe zyrtarët e partive politike dhe qeverisë në Beograd, duke përfshirë përfaqësues të ministrisë serbe për Kosovën, anëtarë të parlamentit të Serbisë, përfaqësues nga Partia Demokratike e Serbisë, Partia G17 Plus, Partia Socialiste e Serbisë, Partia Liberal Demokratike dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Qëllimi i tryezës ka qenë diskutimi i çështjes së “dualizmit” institucional, të njohur edhe si “paralelizëm”, në komunat me shumicë serbe.

Takimi ka rastisur të mbahet në kohën e intervenimit të policisë së Kosovës në veri dhe si rrjedhojë, diskutimi i disa temave më të përgjithshme ka qenë i paevitueshëm. Takimi poashtu është mbajtur pas aplikimit të masave të ‘reciprocitetit’ nga ana e qeverisë së Kosovës, me të cilën janë ndaluar eksportet e Serbisë në Kosovë. Pjesëmarrësit kanë përshëndetur reagimin e

Partisë së Pavarrur Liberale (SLS), e cila kishte bojkotuar mbledhjen e kuvendit si përgjigje ndaj këtyre masave. Megjithatë, disa pjesëmarrës kanë thënë se anëtarët serbë në qeverinë dhe parlamentin e Kosovës do të duhej të bënin më shumë dhe të reagonin më shpejtë ndaj politikave të caktuara të cilat dëmtojnë interesat e komunitetit serb. Përfaqësuesit e SLS-së kanë reaguar duke theksuar se fuqia e tyre për të ndaluar qeverinë e Kosovës në ekzekutimin e politikave të caktuara, sic është ajo e ‘reciprocitetit’, është e kufizuar dhe se kjo duhet të kuptohet nga të gjithë akterët politik serbë.

Përfaqësuesit e SLS-së kanë konfirmuar se ata përkrahin një zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve dhe se e mbajnë përgjegjës Beogradin dhe Prishtinën për trazirat në komunat veriore të dominuara nga serbët: Beogradin për shkak të vendimit për tu “tërhequr” nga dialogu dhe Prishtinën për shkak të aplikimit të pamatur të masave të reciprocitetit dhe për dërgimin e njësisë policore në veri. Sikur Beogradi të kishte marrë pjesë në takimin në Bruksel në korrik, ndoshta masat e reciprocitetit dhe intervenimi i policisë në veri do të ishin evituar. Një folës ka thënë se janë katër akterë kyç për gjetjen e një zgjidhjeje afatgjate për veriu: Beogradi, Prishtina, komuniteti ndërkombëtar dhe autoritetet lokale. Ministrat nga rradhët e SLS-së nuk kanë marrë pjesë në mbledhjen e qeverisë ku është marrë vendimi për ndalimin e prodhimeve serbe. Një nga përfaqësuesit e SLS-së ka treguar se SLS ka reaguar duke kontaktuar ndërkombëtarët, qeverinë, ndërsa anëtarët e saj nuk kanë marrë pjesë në mbledhjen e rradhës të parlamentit.

Për një kohë të shkurtër, pjesëmarrësit kanë diskutuar dialogun Beograd-Prishtinë. Njëri nga diskutuesit ka fajësuar Beogradin për ndërprerjen e dialogut, e sidomos vendimin e kryesuesit të ekipit të Beogradit për anulimin në minutën e fundit të pjesëmarrjes së tij në mbledhjen e Brukselit, ku edhe disa marrëveshje qenë paraparë të arrihen, duke përfshirë edhe ato rreth vulave doganore. Për mungesën e progresit, ai poashtu u ka vënë fajin mosmarrëveshjeve të brendshme evropiane dhe procesit burokratik. Ky folës ka theksuar se intervenimi i policisë së Kosovës në veri do të “shkatërronte” procesin. Shumë nga pjesëmarrësit kanë theksuar se intervenimi i policisë së Kosovës në veri nuk ka qenë i papritur sepse zyrtarë të ndryshëm evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës tashmë kishin tërhequr vëmendjen se në rast se palët dështojnë në arritjen e progresit rreth vulave doganore, ata do të mbështesnin vendimin e Kosovës për aplikimin e masave të reciprocitetit në tregti.

Pjesëmarrësit kanë përkrahur vazhdimin e dialogut dhe kanë thënë se arritja e tri marrëveshjeve të para ka treguar se është process produktiv, por kanë konkluduar se masat e reciprocitetit nga Prishtina dhe intervenimi i policisë në veri mund ta vënë ate në rrezik. Beogradi dhe Prishtina duhet të jenë të afta t’i tejkalojnë presionet nga partitë opozitare dhe të marrin vendimet e duhura. Një folës tjetër ka thënë se në mënyrë që dialogu të jetë i suksesshëm, marrëveshjet duhet të implementohen menjëherë. Ai ka shpjeguar se SLS dhe Lista e Bashkuar Serbe (JSL) kanë vepruar bashkarisht si kundërpërgjigje ndaj masave të reciprocitetit të marra nga Prishtina. “Kemi bërë krejt cka mundemi, kemi folur me ndërkombëtarët, me zyrtarët më të lartë të Kosovës dhe na është thënë se këto masa nuk do të zgjasin gjatë”. Folësi ka theksuar se serbët e Kosovës nuk janë vetëm një ‘zbukurim’ në institucionet e Kosovës, dhe se ata do t’i shfrytëzojnë të gjitha mjetet në dispozicion për të ndikuar në politika, porse fuqia e tyre është e kufizuar dhe se kritikët duhet ta kuptojnë këtë. “Ne jemi vetëm 13 anëtarë në një parlament me 120 deputetë”.

Në sesionin e dyte të tryezës, pjesëmarrësit janë fokusuar në çështjen e “dualizmit” institucional në komunat me shumicë serbe në Kosovë. Njëri nga kryetarët e komunave ka theksuar se ai ka komunikuar me institucionet lokale serbe në Kosovë, të njohura edhe si institucione paralele, dhe se ka kërkuar nga ta që të punojnë së bashku në gjetjen e zgjidhjes rreth “dualizmit” institucional. Ai ka thënë se në fillim institucionet e Serbisë nuk kanë treguar gatishmëri për të bashkëpunuar por që një komunikim më i mirë tashmë është krijuar. Ai ka thënë se qeveria e Serbisë duhet ta ketë një qasje të njejtë, që ta inkurajojë bashkëpunimin mes institucioneve të cilat punojnë për interesat e komunitetit serb. Ai gjithashtu ka theksuar se koordinimi dhe bashkëpunimi do të ishte i dobishëm sidomos në ndërtimin dhe renovimin e shkollave, spitaleve, qendrave kulturore si dhe në përmirësimin e përgjithshëm të sistemit të edukimit.

Një diskutues tjetër poashtu ka përkrahur idenë e koordinimit të aktiviteteve në mes të dy grupeve të institucioneve deri në gjetjen e zgjidhjes me anë të dialogut Beograd-Prishtinë. Ky diskutues po ashtu ka thënë se duhet të bëhet vlerësimi i situatës së tanishme në mënyrë që të shihet se cilat fusha mund të përmirësohen. “Ne duhet të shohim se si funksionojnë shërbimet tona. Janë rreth 250 njerëz që punojnë në klinikën e Gracanicës; ne duhet të shohim se si funksionon kjo, dhe kush është duke paguar sa për këtë shërbim”. Zgjidhja e “dualizmit” është e pamundur pa Beogradin. Së këndejmi, një dialog i sinqertë me Beogradin është gjithmonë i nevojshëm. Një numër folësish kanë kritikuar kryesuesin e ekipit negociator për faktin se gjatë vizitës së tij në Kosovës në qershor, ai është takuar me kryetarin e një komune të caktuar nga Beogradi e që anjëherë nuk është votuar në zgjedhje kurse ka anashkaluar tërësisht zyrtarët lokal serbë të zgjedhur nga votuesit. Njëri nga pjesëmarrësit ka propozuar hapjen e një univerziteti në Gracanicë. “Kjo do të ishte një politikë llogaridhënëse, që studentët tanë të studiojnë në Gracanicë në vend se të shkojnë gjithandej Serbisë e të mos kthehen më kurrë”.

Askush nuk duhet ta ketë monopolin e të folurit në emër të të gjithë serbëve në Kosovë, por përfaqësuesit të cilët kanë fituar votat e popullit duhet të kenë zë më të fuqishëm sesa “të caktuarit”. Serbët e Kosovës gjenden mes dy zjarresh, mes beogradit e Prishtinës. Shëndetësia dhe shkollimi janë problemet më të mëdha dhe serbët duhet të bëjnë përmirësime në këto fusha bashkë me Beogradin e Prishtinën ndërsa të njejtat duhet të jenë tema të diskutimit mes Beogradit e Prishtinës.

Institucionet lokale në Kosovë të krijuara nga Beogradi nuk kanë treguar shumë rezultate, duke pasë parasysh shumën e të hollave që kanë marrë nga Beogradi qysh nga krijimi i tyre në vitin 2008. “Une nuk jam kundër dhënies së fondeve për shërbimet shëndetësore dhe edukative për serbët e Kosovës, ato janë të nevojshme, por unë nuk e përkrah krijimin e institucioneve të cilat nuk funksionojnë” ka theksuar një folës.

Rreth shqyrtimit të çështjes se a do të duhej Beogradi të organizonte edhe një palë zgjedhje tjera lokale në Kosovë në vitin e ardhshëm, njëri nga folësit ka thënë se për Beogradin do të ishte shumë e vështirë që mos t’i organizojë ato. Një diskutues tjetër ka thënë se është poashtu e vështirë për Serbinë që ti organizojë zgjedhjet lokale në Kosovë: një gjë e tillë do të shkaktonte konflikt me komunitetin ndërkombëtar sidomos tani kur Serbia ka intensifikuar përpjekjet e saj për t’iu bashkuar BE-së. Po i njejtë folës ka vlerësuar se organizimi i zgjedhjeve lokale në vitin 2008 në Kosovë ka prodhuar disa rezultate të papritura: ka sjellë në pushtet përfaqësuesit e vijës

radikale. “Zgjidhja e ‘dualizmit’ institucional duhet të jetë pjesë e një pakoje që do të përfshinte një vendim të duhur rreth zgjedhjeve dhe kthimin në system. Kjo pako do të duhej të zgjidhte poashtu çështjet burokratike; nuk mund t’i kemi qindra njerëz të punësuar në klinika dhe institucione lokale të cilët marrin rroga pa bërë asgjë”.

Si përfundim, pjesëmarrësit janë pajtuar se “dualizmi” institucional nuk do të mund të zgjidhet pa bashkëpunimin mes Beogradit dhe serbëve të Kosovës. Takimet mes serbëve të Kosovës dhe Beogradit duhet të jenë të hapura dhe të mbahen më shpesh; ato do të duhej të ishin ngjarje normale. Një nga deputetët më me përvojë në parlamentin serb ka ofruar ekspertizë teknike dhe këshilla për anëtarët serbë të parlamentit të Kosovës rreth punës së tyre në legjislativ duke ka propozuar koordinim të vazhdueshëm. Në këtë aspekt, është sugjeruar që të përdoret përvoja e bashkëpunimit mes Serbisë dhe serbëve në Kroaci si dhe Hungarisë e hungarezëve jashtë Hungarisë. Në ndërkohë, institucionet lokale serbe dhe institucionet e financuara nga Beogradi duhet të provojnë të bashkëpunojnë në fushat ku një gjë e tillë është e mundur, mirëpo vendimi final në lidhje me “dualizmin” i mbetet Beogradit.

Bashkëpunimi mes përfaqësuesve politik të serbëve të Kosovës dhe Beogradit

CIG ka organizuar një takim mes një numri të përfaqësuesve serbë të Kosovës dhe kryetarit të parlamentit të Serbisë. Pjesëmarrësit serbë të Kosovës të cilët përfaqësojnë parti të ndryshme politike në institucionet e Kosovës, si nga qeveria ashtu edhe nga opozita, kërkuar bashkëpunim më të madh dhe përkrahje nga institucionet e Serbisë.

Konkludimi i përgjithshëm i përbashkët i këtij takimi ishte se është e rëndësishme që zyrtarët relevant në Beograd të vendosin një kanal të komunikimit dhe bashkëpunimit me serbët të cilët punojnë në institucionet e Kosovës. Pjesëmarrësit e takimit janë pajtuar se duke folur me zyrtarët serbë në institucionet e Kosovës, Serbia nuk e cënon politikën e shtetit serb ndaj Kosovës.

Me rastin e dhënies së opinionit rreth pjesëmarrjes së serbëve në zgjedhjet e Kosovës, në dhjetor të vitit 2010, qeveria e Serbisë nuk ua kishte ndaluar serbëve pjesëmarrjen dhe kishte thënë se ata janë të lirë të vendosin vetë rreth kësaj çështjeje, duke shtuar se ata të cilët vendosin të marrin pjesë nuk duhet të ‘dënohen’ për vendimin e tyre. Rreth 26,000 votues serbë morën pjesë në zgjedhje duke zgjedhur 13 anëtarë të parlamentit.

Në takim të gjithë janë pajtuar se këta zyrtarë të zgjedhur janë përfaqësues legjitim të atyre të cilët kanë votuar për ta dhe se ata meritojnë njohje dhe bashkëpunim ng ana e politikanëve në Beograd. Gjatë diskutimit gjithashtu është theksuar disa herë se uniteti Brenda serbëve të Kosovës dhe mes tyre e Beogradit është faktor kyc për përmirësimin e situatës së serbëve të Kosovës.

Anëtarët serbë të parlamentit të Kosovës kanë kërkuar ndihmë dhe këshilla rreth punës së tyre në parlament, përfshirë këtu mbajtjen e këshillimeve rreth draftligjeve të cilat janë duke u shqyrtuar në parlamentin e Kosovës. Një bashkëpunim i tillë duhet të institucionalizohet dhe duhet të shëndrrohet në praktikë ditore. Një pjesë tjetër e këtij bashkëpunimi do të duhej të ishte draftimi i një strategjie të përbashkët rreth Kosovës. Ky propozim erdhi nga të dyja palët, nga pjesëmarrësit nga Kosova dhe ata nga Beogradi. Një strategji e tillë duhet të pasqyrojë

opinionet e serbëve të Kosovës. Gjithashtu është theksuar se puna e CIG krijon një bazë të mirë dhe një ekip të mirë për hartimin e një strategjie të tillë.

Politikanët serbë të Kosovës kanë thënë se përkrahja e Beogradit është e nevojshme për forcimin e rolit dhe të influencës së serbëve në politikën e Kosovës. Ata ua rikujtuan të pranishmëve se kjo ndoshta ka qenë hera e fundit kur serbët kanë mundur të arrijnë një numër aq të lartë prej 13 përfaqësuesisht në parlament. Në parlamentet e ardhshme ata nuk presin se ky numër do të shkoj përtej 10 ulëseve të garantuara.

Zyrtarët lokal serbë të Kosovës kanë informuar kryetarin e parlamentit rreth shumë rezultateve praktike që kanë dalur nga angazhimi i tyre për të përmirësuar jetën e përditshme të popullsisë serbe në Kosovë. Në këtë takim është kërkuar poashtu nga kryetarja e parlamentit që të shfytëzojë autoritetin që ka që ti bindë zyrtarët e tjerë përgjegjës në Beograd për nevojën e vendosjes së komunikimit dhe bashkëpunimit me përfaqësuesit serbë në institucionet e Kosovës.

Pas takimit, pjesëmarrësit kanë dhënë deklaratë në mediat e shkruara dhe ato elektronike, si dhe kanë pasur një takim me grupin parlamentar të Partisë Liberal Demokratike.

Pjesëmarrësit

Renditje alfabetike në gjuhën angleze

Sasa Djokic, Partia Demokratike Serbe e Kosovës dhe Metohisë
Slavica Djukic Dejanovic, Parlamenti i Serbisë
Oliver Ivanovic, Ministria Serbe për Kosovë e Metohi
Dusan Janjic, Forumi për Marrëdhënie Etnike
Dalilbor Jevtic, Partia e Pavarur Liberale
Vesna Jovanovic, Partia e Pavarur Liberale
Biljana Jovic, Qendra për Studime të Migrimit
Nebojsa Kenic, Lista e Bashkuar Serbe
Dragisa Krstovic, Partia Liberal Demokratike
Gradimir Mikic, Lëvizja Serbe e Ripërtritjes
Vesna Mikic, Lista e Bashkuar Serbe
Petar Miletic, Partia e Pavarur Liberale
Bratislav Nikolic, Partia e Pavarur Liberale
Dragan Nikolic, Radio Kompas
Randjel Nojkic, Lëvizja Serbe e Ripërtritjes
Veljko Odalovic, Partia Socialiste e Serbisë
Zoran Ostojic, Partia Liberal Demokratike
Stojanka Petkovic, Partia G17 Plus
Dusica Petrovic, Parlamenti i Serbisë
Dejan Radenkovic, Partia Socialiste e Serbisë
Nenad Radosavljevic, RTV Mir
Branko Ruzic, Partia Socialiste e Serbisë
Vesimir Savic, Lista e Bashkuar Serbe
Nebojsa Simic, Komuna e Kamenicës
Predrag Simic, Universiteti i Beogradit
Bojan Stojanovic, Partia e Pavarur Liberale
Momcilo Trajkovic, Lëvizja Serbe e Ripërtritjes
Rada Trajkovic, Lista e Bashkuar Serbe
Jelena Trivan, Partia Demokratike
Lukas Beglinger, Departamenti Federal Zvicrran i Punëve të Jashtme
Shpetim Gashi, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Alex Grigorev, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Arber Kuci, Këshilli për Qeverisje Përfshirëse
Norbert Ruetsche, Departamenti Federal Zvicrran i Punëve të Jashtme